




ODA EKONOMIKE KOSOVA CHAMBER
E KOSOVËS OF COMMERCE

Adresa: Nena Terezë, Nr:20, 10000 Prishtinë - KOSOVË
Tel: +381 (0) 38 224 741, Tel&Fax: +381 (0) 38 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org



STATUTI I ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS

Prishtinë

Korrik 2017

STATUTIN E ODËS EKONOMIKE TË KOSOVËS

KREU I

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Ky statut rregullon detyrat dhe aktivitetet e Odës Ekonomike të Kosovës të drejtat dhe detyrat e anëtarëve së Odës, menaxhimin e çështjeve të Odës, format e organizimit dhe punës së Odës, themelimin e zyrave të Odës jashtë vendit, Arbitrazhit të Përhershëm në Odë, bashkëpunimin me autoritetet shtetërore, organizatat dhe odat tjera, aktet e përgjithshme të Odës dhe kalimin e saj, punën publike të Odës, shërbimin profesional të Odës dhe realizimin e fondeve për punën e Odës.

Neni 2

Oda Ekonomike e Kosovës në pajtim me dispozitat e ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Nr. 2004/7 është organizatë profesionale jo-fitimprurëse, subjekt juridik i pavarur dhe organizatë e biznesit të të gjitha subjekteve juridike të angazhuara në aktivitete ekonomike të themeluara në territorin e Republikës së Kosovës që dëshirojnë të jenë anëtare të Odës.

Neni 3

Oda ka fushë veprimtarinë në vijim:

- Harmonizon, përfaqëson dhe mbron interesat e anëtarëve të Odës në raport me institucionet e pushtetit qendror;
- Merr pjesë në pajtim me rolin dhe detyrat, në dialogun social në nivel të Kosovës;
- Ju ofron anëtarëve shërbime afariste, këshillëdhënëse në funksion të përparimit të veprimtarive ekonomike dhe
- I ushtron autorizimet publike në pajtim me ligjin për Odën, legjislacionin në fuqi dhe me këtë statut.

3.1. Oda organizohet dhe vepron me qëllim të përparimit të ekonomisë së tregut, ndërmarrësisë dhe nxitjes së konkurrencës tek anëtarët e vet.

3.2. Për realizimin e qëllimeve nga paragrafi i mëparshëm i këtij neni, Oda e orienton punën e vet veçanërisht në:

- Përfaqësimin në kuptim të lobimit të interesave të anëtarëve të Odës para organeve dhe institucioneve kompetente shtetërore, në veçanti në përgatitjen e legjislacionit ekonomik, në përcaktimin e masave të politikës ekonomike si dhe në fillimin e iniciativave për përmirësimin e rregullativave të caktuara në lëmin e ekonomisë;
- Sigurimin e shërbimeve afariste-profesionale për nevojat e anëtarëve;
- Dhënien e këshillave, informatave dhe të ndihmës profesionale me qëllim të përmirësimit të rezultateve në punën e anëtarëve të Odës;
- Dhënien e ndihmës profesionale anëtarëve të Odës për zhvillimin e veprimtarive konkrete, përvetësimin e teknologjive dhe metodave bashkëkohore në punë, nxitjen e veprimtarisë hulumtuese dhe zhvillimin e të arriturave tekniko-teknologjike, përparimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe standardeve të produkteve e të tjera;
- Nxitjen e zhvillimit të ekonomisë së Kosovës e të mundësive dhe potencialeve të saj, në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar;

- Nxitjen e investimeve në ekonominë e Kosovës, në veçanti në tërheqjen e investimeve direkte nga jashtë, duke u angazhuar në përmirësimin e vazhdueshëm të ambientit për tërheqjen e investitorëve;
- Përparimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në vend;
- Bashkëpunimin me Qeverinë, ministritë përkatëse dhe institucionet tjera për të gjitha çështjet me interes për ekonominë ose për një numër të caktuar të anëtarëve të Odës;
- Përcaktimin e qëndrimeve dhe mendimeve të harmonizuara lidhur me përmirësimin e kushteve dhe të ambientit për zhvillimin e veprimtarive biznesore;
- Participimin në ndërtimin e qëndrimeve të përbashkëta për çështjet ekonomike me asociacionet e odave tregtare–industriale dhe Federatave të Industrialistëve të Evropës përfshirë edhe anëtarësimin e Odës në këto organizata;
- Nxitjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik me botën në veçanti në promovimin e produkteve të ekonomisë së Kosovës të shërbimeve, organizimin e panairove dhe ekspozitave, vizitave të delegacioneve ekonomike etj;
- Përfaqësimin e interesave të anëtarëve të Odës përkatësisht të punëdhënësve në ekonomi, në dialogun tre-partitë sociale në nivel të Kosovës;
- Sigurimin dhe kombinimin e vazhdueshëm të informatave për të dhëna të rëndësishme nga ekonomia e vendit dhe ajo botërore;
- Organizimin dhe nxitjen e formave adekuate për arsimim të vazhdueshëm plotësues funksional dhe për përtëritjen e diturive për profilet e ndryshme të ekspertëve dhe menaxherëve në ekonomi;
- Nxitjen e anëtarëve të Odës që të ndërmarrin aktivitete në lëminë e mbrojtjes së ambientit jetësor, përmirësimin e cilësisë së punës, standardeve në punë e çështje tjera me interes për ekonominë, në veçanti për ndërmarrjet e vogëlle të mesme;
- Përcaktimin dhe kultivimin e zakoneve të mira afariste, të moralit afarist dhe të rregullave të sjelljes afariste të anëtarëve të Odës në raport me persona të tretë dhe në treg përgjithësisht;
- Dhënien e ndihmës profesionale në zgjidhjen e kontesteve përmes arbitrazhit apo me ndërmjetësim të drejtpërdrejtë, në interesin e anëtarit të Odës;
- Mbështetjen dhe përgatitjen e anëtarëve të Odës gjatë vendosjes së kontakteve të biznesit, në veçanti me partnerët e jashtëm, dhe
- Kryerjen e punëve të veçanta tjera me interes për anëtarët e Odës.

Neni 4

4.1. Anëtarësimi në Odë dhe largimi nga ajo është i lirë dhe në baza vullnetare.

4.2. Odën e qeverisin anëtarët e saj përmes përfaqësuesve të tyre nëpër shoqata, njësi rajonale dhe përmes anëtarëve të zgjedhur në organet e Odës.

4.3. Anëtari i Odës konsiderohet subjekti juridik apo fizik që nënshkruan Marrëveshjen për Anëtarësim në Odë. Anëtarësimi në OEK rrjedhë nga dita e nënshkrimit të kontratës –Marrëveshjes për anëtarësim në OEK.

4.4. Në Marrëveshjen e Anëtarësimit në OEK, janë të specifikuara nivelet e anëtarësimit dhe të drejtat dhe obligimet reciproke të palëve për secilin nivel. Mos-përmbushja e detyrimeve bazë të parapara me marrëveshjen e anëtarësimit nga cila do palë kontraktuese, paraqet shkelje të dispozitave të Statutit të Odës. Në rast të shkeljeve të

tilla, pala e dëmtuar do t'i paraqet Gjykatës së Nderit rastin për shqyrtim ku do të nxjerrën rekomandimet përkatëse në pajtim me Statutin e Odës.

Neni 5

5.1. Parim themelor i organizimit të brendshëm dhe i funksionimit të Odës sipas këtij Statuti është organizimi i anëtarëve:

- Në Shoqata,
- Në Njësitë rajonale dhe
- Në Organet e Odës.

Neni 6

6.1. Odën e qeverisin përfaqësuesit e zgjedhur në organet e Odës, në organet e shoqatave sektoriale dhe në njësitë rajonale.

6.2. Secili anëtar, drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesit të vet ka të drejtën aktive dhe pasive të votimit për të gjitha organet nga paragrafi i mëparshëm i këtij neni.

Neni 7

Emërtimi i Odës është: ODA EKONOMIKE E KOSOVËS;

Oda ka zotësi juridike;

Oda posedon numër fiskal : 600181888;

Selia e kryesore e Odës është në Prishtinë, rruga Nënë Terezë nr. 20, 10000;

Neni 8

8.1. Oda e ka vulën e vet të rrumbullakët, e cila përmban emërtimin dhe selinë.

8.2. Shoqatat sektoriale mund të kenë vulën e rrumbullakët me emërtimin e Odës si dhe me emërtimin e vet e të selisë së vet.

8.3. Forma, përmbajtja dhe dimensionet e vulave rregullohen me akt të veçantë.

Neni 9

Veprimtaria e Odës është transparente. Transparenca në punën e Odës sigurohet në harmoni me Ligjin dhe me këtë statut.

KREU II

QËLLIMET DHE DETYRAT E ODËS

Neni 10

10.1. Detyrat kryesore të OEK-ut, për realizimin e qëllimeve të saj janë:

- Përfaqësimi i interesave të harmonizuara të anëtarësisë në tërësi me iniciativa të reja;
- Bashkëpunimi me organet e pushtetit në formulimin e strategjisë së zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, zhvillimit rajonal, struktural dhe politikës adekuate industriale,
- Përmirësimin e infrastrukturës ekonomike dhe në lëminë e politikës ekonomike mbrojtëse;

- Pjesëmarrja në dialogun ekonomik dhe social bashkë me asociacionet e tjera afariste, shoqatat e interesit, sindikatat, etj ;
- Zhvillimi dhe kryerja e shërbimeve të sistemit integral të afarizmit dhe të informacionit; lidhur me bazat e të dhënave vendase dhe të jashtme, sidomos në lëmin e kërkesës dhe ofertës të formave të ndryshme të bashkëpunimit ekonomik dhe karakteristikave ekonomike të përgjithshme e të veçanta të tregut të Kosovës dhe vendeve të jashtme;
- Promovimi i tregtisë së jashtme me anë të organizimit të kontakteve afariste në mes të partnerëve vendas dhe të atyre të huaj paraqitjes së përbashkët në panaire, prezantimit të bizneseve, delegacioneve tregtare të brendshme dhe të jashtme me marrjen e propozimeve për investime të përbashkëta të kompanive etj;
- Pjesëmarrja në procesin permanent të inovacioneve dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve e të shërbimeve dhe në promovimin e standardeve teknike evropiane për ambientin dhe programet ekologjike;
- Dhënia e këshillave për zhvillim, veçanërisht lidhur me kriteret për fitimin e bonitetëve financiare, mjeteve nga buxheti dhe burimet e tjera, në përgatitjen e programeve investive në biznes dhe konsultimet rreth ristrukturimit dhe rinovimit të bizneseve;
- Ndhima profesionale dhe konsultimet rreth zgjidhjes së çështjeve të afarizmit vijues siç është sigurimi i mjeteve qarkulluese, përdorimi racional i energjisë, racionalizimi i shpenzimeve të xhiros, furnizimi me lëndë të parë, mënjanimi i pengesave afariste, ndihma për hartimin e programeve të ristrukturimit dhe të zhvillimit të kompanive të caktuara;
- Ndhima për hartimin e programeve të zhvillimit dhe të investimeve, sidomos për
- Bizneset e vogla dhe të mesme;
- Ndhimon ndërmarrjet në kërkesat për dhënien e dokumenteve tregtare, sidomos certifikatave për origjinën e mallit dhe dokumenteve të tjera, në përputhje me ligjet në fuqi;
- Angazhimi për zgjidhjen e kontesteve ekonomike përmes arbitrazhit të përhershëm;
- Bashkëpunimi me institucionet e tjera në përcaktimin e nevojave për trajnime profesionale për komunitetin e biznesit si dhe trajnimeve të vazhdueshme për subjektet e anëtarësuar në Odë;
- Pjesëmarrja në sistemin permanent në trajnimet e të punësuarve bëhet në harmoni e me statutin dhe dispozitat tjera të veçanta të odës.

Neni 11

Oda ushtron disa autorizime publike si dhe lëshon vërtetime dhe dokumente tjera që mbështeten në autorizime ligjore apo në akte të organeve kompetente shtetërore, që mund t'i delegohen Odës, me qëllim të lehtësimit të procedurës për marrjen e tyre dhe në interes të subjekteve ekonomike.

Neni 12

Oda lëshon certifikata, vërtetime dhe dokumente tjera për çështje nga veprimtaria e saj për të cilat mban evidencë dhe konfirmon fakte të caktuara, të cilat anëtarët e Odës i shfrytëzojnë në punën e tyre në vend dhe në botë.

DETYRAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË ODËS

Neni 13

Anëtarët e Odës janë të barabartë dhe kanë të drejtat dhe obligimet e njëjta në Odë.

Neni 14

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Odës janë

- Zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Odë;
- Nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të kontrollojë punët e Odës;
- Marrin pjesë në punën e grupeve profesionale dhe forma të tjera të organizimit në Odë;
- Këmbejnë informata dhe përvoja, kryejnë konsultime dhe organizojnë këshillime;
- Iniciojnë miratimin dhe ndryshimin e ligjeve, rregulloreve, dhe masave që janë me interes për ekonomi;
- Shfrytëzojnë ndihmën profesionale të Odës në çështjet që janë brenda fushëveprimit të Odës;
- Shfrytëzojnë shërbimet e kryera nga Oda të përcaktuara me ligjin mbi Odën;
- Para Gjykatës së Nderit paraqesin rastin e shkeljes së rregullave të moralit (praktikat e mira të biznesit) në lidhje me marrëdhëniet afariste përpara Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit paraqesin kontestet e ndërsjella për një zgjidhje paqësore nëpërmjet ndërmjetësimit dhe për të vendosur mbi kontestet e tilla;
- Japin të dhëna dhe informacione të nevojshme për të kryer detyrat e veta Oda;
- Përbahen dispozitave të statutit, vendimeve, konkluzioneve dhe akteve tjera të organeve të Odës dhe zhvillojnë përgjegjësinë e ndërsjellë për kryerjen e detyrave të Odës;
- Kryejnë me rregull pagesën mbi anëtarësimin në Odë.

KREU IV

QEVERISJA E ODËS

Neni 15

15.1. Oda qeveriset sipas parimeve të qeverisjes korporative.

15.2. Anëtarët e Odës janë të organizuar sipas qeverisjes korporative, bashkimit në shoqatat sektoriale dhe sipas parimit rajonal në Njësitë Rajonale të cilat janë pjesë integrale të Odës dhe të strukturës së saj drejtuese poshtë-lartë.

15.3. Shoqatat sektoriale dhe Njësitë Rajonale janë baza zgjedhore për zgjedhjen e përfaqësuesve në organet e Odës të nivelit të sektorit, rajonal dhe qendror.

15.4 . Zgjedhja e të gjitha organeve kryhet në pajtim me procedurën e zgjedhjeve, ashtu siç është definuar me këtë Statut dhe me rregullat e veçanta për zgjedhje që do t'i miratoj Kuvendi i Odës.

Neni 16

Organet e Qeverisjes së Odës

Organet e qeverisjes së Odës janë:

- Kuvendi i Odës;
- Këshilli Drejtues i Odës;
- Kryetari i Odës;
- Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 17

Kuvendi i Odës

17.1. Kuvendi i Odës është organi më i lartë i Odës.

17.2. Kuvendi i Odës është i përbërë nga përfaqësues të zgjedhur të anëtarëve të Odës në pajtim me procedurën e zgjedhjeve të përcaktuar me këtë statut.

17.3. Kuvendi i Odës udhëhiqet nga Kryesuesi i Kuvendit të Odës.

Neni 18

18.1. Kuvendi i Odës i ka 71 vende përfaqësuese, të cilat janë të ndara ndërmjet Shoqatave Sektoriale dhe Njësive Rajonale proporcionalisht sipas numrit të anëtarëve që përfaqësojnë në Odën Ekonomike të Kosovës:

- Shoqatat Sektoriale 90%
- Njësiti Rajonale 10%

18.2. Vendet përfaqësuese të shoqatave të degëve dhe të Njësive Rajonale ndahen në atë mënyrë që drejtpërdrejtë merren parasysh këto kriteret:

- numri i anëtarëve dhe struktura e tyre;
- sigurimi i përfaqësimit të interesave të anëtarëve nëpër regjione dhe shoqata.

18.3. Këshilli Drejtues i Odës definon kohën e mbajtjes së zgjedhjeve dhe e mbikëqyrë dhe zbaton Aktin Normativ për përcaktimin e vendeve përfaqësuese në Kuvend. Vendet përfaqësuese duhet të caktohen në harmoni me kriteret e përfaqësimit në organet e Odës në pajtim me këtë Akt Normativ të nxjerrur nga Kuvendi.

Neni 19

19.1 Të paktën 10 anëtarë të organizuar në shoqata sektoriale dhe Njësiti Rajonale mund të propozojnë listën e kandidatëve për zgjedhjen e përfaqësuesve në Kuvend.

19.2 Secili anëtar i OEK-ut ka së paku një votë dhe një numër të caktuar votash shtesë në përpjesëtim me strukturën e kapitalit, numrin e punonjësve dhe kontributin e përgjithshëm në buxhetin e OEK-ut.

Neni 20

20.1. Personat e zgjedhur për të përfaqësuar anëtarët e Kuvendit dhe Këshillit Drejtues të OEK-ut, zgjidhen me mandat katër vjeçar me mundësi rizgjedhje.

20.2. Mandati i anëtarit të Odës ndërpritet para afatit për të cilin ai është zgjidhur në rast të:

- Ndërprerjes së anëtarësimit në Odë;
- Ndërprerjes së marrëdhënies së punës në ndërmarrjen anëtare në Odë;
- Dorëheqjes së tij;
- Në rast të revokimit nga autoriteti që e ka zgjedhur atë;

20.3. Përfaqësuesi i sapo zgjedhur kompletton mandatin e përfaqësimit të anëtarit, mandati i të cilit ndërpritet para skadimit të zgjedhur.

Neni 21

Komisioni për zbatimin e zgjedhjeve dhe mandateve të anëtarëve të organeve të OEK-ut që e cakton Kuvendi i OEK-ut, është përgjegjës për ligjshmërinë e zbatimit të zgjedhjeve, verifikimin e mandateve të organeve të OEK-ut dhe revokimin e përfaqësimit të anëtarëve në organet e OEK-ut, në rast të mosrespektimit të marrëveshjes së anëtarësisë në OEK, si dhe mosrespektimit të dispozitave ligjore të Odës Ekonomike të Kosovës.

Neni 22

22.1. Kuvendi i Odës i ka këto autorizime:

22.1.1. Miraton:

- Statutin e OEK-ut dhe ndryshimet e tij;
- Programin e punës, planin financiar dhe raportet mbi realizimin e tyre;
- Rregullat procedurale për punën e Arbitrazhit të Përhershëm dhe Këshillit të Nderit;
- Rregulloren mbi punën e vetë;

22.1.2. Zgjedhë :

- Zgjedhë Kryesuesin e Kuvendit të Odës
- Zgjedhë Kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës;
- Në mbështetje të propozimit të Kryetarit të Odës zgjedh nënkryetaret, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe zgjedh Sekretarin e Përgjithshëm të Odës;
- Emëron Kryesuesin e Arbitrazhit të Përhershëm, Arbitrat dhe anëtarët e Gjykatës së Nderit;

22.1.3. Përcakton:

- Përqindjen e kuotes së anëtarësisë;
- Qëndrime lidhur me çështje të rëndësishme të sistemit ekonomik, të politikës zhvillimore dhe aktuale ekonomike;
- Qëndrime, konkluzione dhe iniciativa lidhur me çështje që janë në interes të anëtarëve dhe ua dërgon organeve dhe institucioneve kompetente shtetërore;
- Iniciativa për përgatitjen e dispozitave ligjore dhe të tjera nga lëmi i ekonomisë;
- Masa dhe aktivitete për nxitjen e investimeve, në veçanti të investimeve direkte nga jashtë në ekonominë e Kosovës
- Mendime dhe qëndrime të Odës për përmirësimin e kushteve të punës të subjekteve ekonomike dhe për çështje të tjera nga veprimtaria e Odës;
- Masa dhe aktivitete për përparimin dhe promovimin e klimës së biznesit në vend;
- Kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve (anëtarëve) në Kuvendin e Odës nga shoqatat sipas veprimtarive dhe nga Njësitë Rajonale;

22.1.4 Me propozimin e Këshillit Drejtues emëron auditorin e brendshëm.

22.2. Shpallja e zgjedhjeve për anëtarë të Kuvendit të OEK-ut, bëhet se paku 30 ditë para skadimit të mandatit të mëparshëm.

22.3. Për kryerjen e disa punëve të caktuara nga fushëveprimi i vet Kuvendi mund të formojë trupa punues të përhershëm ose të përkohshëm.

22.4. Kuvendi nxjerr Rregulloren për formën dhe mënyrën e votimit në organet qeverisëse të OEK-ut.

22.5. Kuvendi, para skadimit të mandatit zgjedhor, shpall zgjedhje dhe njëherit formon Komisionin Zgjedhor për zbatimin e zgjedhjeve për organet e Odës, i cili Komision do të ushtron mandatin e vet deri në konstituimin e Kuvendit të ri.

22.6. Brenda afateve të përcaktuar ligjore mbahet seanca konstituive e Kuvendit, gjatë së cilës zhvillohen këto procedura:

- Seancën Konstituive e kryeson anëtari më i vjetër në moshë i përbërjes së re të Kuvendit nga anëtarët që janë prezent në seancën konstituive.
- Kuvendi zgjedh Komisionin Verifikues për verifikimin e kandidaturave për organet e Odës. Komisioni propozohet në përbërje prej 7 anëtarëve të Kuvendit (5 prej të cilëve vijnë nga Shoqatat Sektoriale dhe 2 nga NJR).
- Pas raportimit të Komisionit dhe verifikimit të mandateve zgjidhet Kryesuesi i Kuvendit.
- Pas zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit, fillon votimi për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, Gjykatës së Nderit dhe Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit.
- Komisioni Verifikues prezanton listën e kandidateve për Kryetar të Odës.
- Të drejtë kandidimi për Kryetar të Odës, kanë të gjithë anëtarët e Kuvendit të konstituar, sipas kritereve të përcaktuar me Aktin Normativ të nxjerr nga Kuvendi.
- Kandidati i cili merr më së shumti vota në Kuvend, zgjedhet Kryetar i Odës. Kryetari i zgjedhur i propozon Kuvendit për miratim zgjedhjen dhe emërimin e kandidateve për Këshillin Drejtues të Odës, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Nënkryetarët e Odës.

Neni 23

23.1. Kuvendi i Odës e miraton Programin e punës së Odës në nivelin qendror pas përgatitjes së koordinuar të programeve të punës së shoqatave të degëve dhe të Njësive Rajonale.

23.2. Kryetari i Odës siguron që programet të para diskutohen dhe të koordinohen në të gjitha pjesët e Odës.

Neni 24

24.1. Kuvendi i Odës mblidhet më së paku 1 (një) herë në vit.

24.2. Kuvendin e thërret dhe e udhëheqë Kryesuesi i Kuvendit në pajtim me Rregulloren mbi punën e Kuvendit.

24.3. Kryesuesi është i obliguar që ta thërras Kuvendin në afat prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës nga ana e Këshillit Drejtues apo nga ana e 1/5 të anëtarëve të Kuvendit.

24.4. Kryesuesi udhëheq me punën e Kuvendit, monitoron implementimin e vendimeve të Kuvendit si dhe në koordinim me Kryetarin e Odës sigurojnë legjitimitet, përfaqësim dhe funksionalitet të organeve të Odës.

24.5. Kuvendin e OEK-ut mund ta thërrasë edhe Kryetari i OEK-ut, nëse paraqitet nevoja për shqyrtim të çështjeve të rëndësishme të veçantë për OEK-un apo çështjet e interesit shtetëror.

Neni 25

25.1. Kuorumi i Kuvendit është arritur po që se në Kuvend marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

25.2. Vendimet janë të plotfuqishme nëse janë miratuar me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, përpos në rastet e shumicës së kualifikuar, e cila definohet në Rregulloren mbi punën e Kuvendit.

25.3 Secili anëtar i Kuvendit ka së paku një votë dhe një numër të caktuar votash shtesë në përpjesëtim me strukturën e kapitalit, numrin e punonjësve dhe kontributin e përgjithshëm në buxhetin e OEK-ut.

Neni 26

Dispozitat e organizimit të punës së Kuvendit janë të përfshira në Rregulloren e punës së Kuvendit të Odës.

Neni 27

Këshilli Drejtues

27.1. Këshilli Drejtues i Odës përbëhet nga 17 anëtarë.

27.2. Kryetari i Odës, njëkohësisht është dhe anëtarë i Këshillit Drejtues sipas pozitës.

27.3. Kryetari i Odës kryeson mbledhjet e Këshillit Drejtues.

27.4 Në propozimin e përbërjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues, Kryetari i Odës është i obliguar të respektoj strukturën përfaqësuese 90% nga shoqatat dhe 10 % nga Njësit Rajonale, dhe kandidatët e propozuar duhet jo vetëm të kenë zotësi menaxhuese, por edhe të sigurohet përfaqësimi proporcional i sektorëve kryesor ekonomik i rajoneve duke përfshirë edhe ndërmarrjet të vogla e të mesme.

27.5. Këshilli Drejtues mund të ftoj për pjesëmarrje, pa të drejt vote, ekspertët nga ekonomia, përfaqësues tjerë të organeve të Odës dhe përfaqësuesit e institucioneve profesionale e publike në pajtim me pikat e rendit të ditës që trajtohen në mbledhjen e Këshillit Drejtues

Neni 28

Këshilli Drejtues i Odës ka këto kompetenca:

- Shqyrton dhe miraton projektin e materialeve dhe të vendimeve për Kuvendin e Odës;
- Merr vendime për realizimin e programeve të punës dhe zbatimin e vendimeve të tjera të Kuvendit;
- Emëron përfaqësuesit e Odës në institucionet, në të cilat Oda delegon përfaqësuesit e saj sipas dispozitave të veçanta;
- I propozon Kuvendit zgjedhjen-emërimin e auditorit të Brendshëm.
- Emëron komisione të përhershme dhe komisione të përkohshme;
- Miraton aktet e përgjithshme të Odës, të cilat nuk bien ndesh me kompetenca të Kuvendit;
- Vendos për hapjen e përfaqësive ekonomike në botë;
- Merr vendime për çështje të tjera në pajtim me Statutin e Odës.

Neni 29

29.1. Këshilli Drejtues të Odës e thërret Kryetari i Odës.

29.2. Kryetari i Odës është i obliguar ta thërras Këshillin Drejtues sipas kërkesës së më së paku $\frac{1}{4}$ të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

29.3. Kuorumi për vendosje valide i Këshillit Drejtues është më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm.

29.4. Secili anëtar i Këshillit Drejtues ka së paku një votë dhe një numër të caktuar votash shtesë në përpjesëtim me strukturën e kapitalit, numrin e punonjësve dhe kontributin e përgjithshëm në buxhetin e OEK-ut.

29.5. Vendimet janë miratuar në mënyrë valide po që se për to votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm, përpos në rastet e shumicës së kualifikuar, të definuar me Rregulloren mbi punën e Këshillit Drejtues.

Neni 30

Këshilli Drejtues mund të emërojë dhe të iniciojë krijimin e organeve të përhershëm ose të përkohshëm profesional të përbërë nga ekspertë të ekonomisë ose të shkencës apo të opinionit profesional në pajtim me programin e punës.

Neni 31

Kryetari i Odës

31.1. Kryetari i Odës e përfaqëson dhe prezanton Odën, drejton punët e saj dhe i zbaton vendimet dhe konkluzionet e organeve të tjera të Odës dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Odës.

31.2. Kryetari i Odës gjatë kryerjes së punëve nga paragrafi 1 i këtij neni merr vendime dhe ndërmerr masa dhe aktivitete në pajtim me Statutin, programin e punës dhe planin financiar, gjegjësisht me vendimet, konkluzionet dhe aktet tjera të organeve të tjera të Odës.

31.3. Kryetari i Odës me qëllim të ushtrimit sa më të suksesshëm të kompetencave të veta mundë të angazhon këshilltarë të veçantë për punë specifike të cilët angazhohen sipas nevojës.

31.4. Kryetari i Odës zgjedhjet nga radhët e përfaqësuesve të anëtarëve të Odës.

Neni 32

32.1. Listën e kandidatëve për kryetar të Odës e përcakton Komisioni për zbatimin e zgjedhjeve të Kuvendit të Odës Ekonomike të Kosovës. Me rastin e përcaktimit të kandidatëve për kryetar Komisioni i merr parasysh të gjitha kandidaturat e paraqitura nga anëtarët veç e veç dhe i propozon Kuvendit listën definitive të kandidatëve që përbëhet nga përfaqësuesit e bizneseve më të rëndësishme, anëtare të Odës, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Kosovës.

32.2. Kandidati i cili fiton numrin më të madh të votave të anëtarëve të Kuvendit konsiderohet se është zgjedhur kryetar i Odës.

32.3. Mandati i kryetarit të Odës zgjatë katër vjet dhe i njëjti person mund të rizgjedhet edhe për një mandat.

Neni 33

Me qëllim të konsultimeve para marrjes së vendimeve për çështje të rëndësishme nga veprimtaria e Odës, Kryetari i Odës mund të thërras mbledhjet e kolegjiut në të cilat marrin pjesë drejtorët e shoqatave të degëve, drejtorët e Njësive Rajonale dhe punëtorët e Odës me autorizime e përgjegjësi të veçanta.

Neni 34

34.1. Kuvendi mund ta revokoj Kryetarin para skadimit të mandatit të tij për këto arsye:

- Nëse nga Gjykata e Nderit konstatohet se Kryetari nuk i zbaton vendimet e Kuvendit apo të Këshillit Drejtues;
- Nëse nga Gjykata e Nderit konstatohet se Kryetari nuk i përmbahet dispozitave të akteve të Odës, veçanërisht të Statutit;
- Nëse Gjykata e Nderit konstaton se është dënuar për ndonjë vepër penale apo shkelje tjera ligjore.
- Nëse Gjykata e Nderit konstaton se është angazhuar me post në një parti politike.
- Sipas kërkesës së tij.

34.2. Nëse Kryetari është i revokuar para skadimit të mandatit, Kryetari i ri duhet të zgjidhet më së largu në afat prej 3 muajsh. Deri sa të zgjidhet kryetari i ri, funksionin e Kryetarit të Odës e Ushtron Kryesuesi i Kuvendit.

34.3. Inicimi i procedurave pran Gjykatës së Nderit për revokimin e Kryetarit, para skadimit të mandatit të tij mundën me propozuar;

- Këshilli Drejtues i Odës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit Drejtues
- Shoqatat sektoriale, me vendimin e shumicës së anëtarëve të Shoqatës
- Njësitë Rajonale, me vendimin e shumicës së Njësive Rajonale.

34.4 Procedurat më të hollësishme rreth revokimit të Kryetarit të Odës, do të rregullohen me aktet nënligjore, të cilat do të jenë në përputhje me Statutin e Odës

Neni 35

Këshilli Mbikëqyrës

35.1. Këshilli Mbikëqyrës i Odës ka kryetarin dhe 4 anëtarë (gjithsej 5 anëtarë) që zgjidhen nga radhët e përfaqësuesve të anëtarëve të Odës. Anëtar të Këshilli Mbikëqyrës mund të zgjidhen edhe ekspertë në lëmin e punës materiale – financiare.

35.2. Mandati i anëtarëve të Këshilli Mbikëqyrës zgjat 4 vjet me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandat.

35.3. Kuvendi i Odës zgjedhë Këshillin Mbikëqyrës të Odës nga radha e përfaqësuesve të anëtarëve që nuk janë anëtarë të Kuvendit, Këshillit Drejtues, dhe stafit udhëheqës dhe menaxherial të Odës.

Neni 36

36.1. Këshilli Mbikëqyrës kontrollon veprimtarinë financiare dhe materiale të Odës dhe për gjendjen e konstatuar e njofton Kuvendin e Odës së paku njëherë në vit dhe Këshillin Drejtues të Odës së paku 2 herë në vit.

36.2. Këshilli Mbikëqyrës është i obliguar së paku njëherë në vit të zbatojë procedurën e auditimit nga një shoqatë e pavarur për auditim.

KREU V

Format e punës dhe të organizimit

Neni 37

Shoqatat sektoriale

Shoqata sektoriale sipas veprimtarisë, gjegjësisht veprimtarive është formë profesionale e organizimit dhe punës në kuadër të Odës përmes së cilës anëtarët e Odës vendosin pavarësisht dhe kryejnë punë dhe detyra në interes të veprimtarisë, gjegjësisht veprimtarive adekuate.

Neni 38

38.1. Shoqata sipas veprimtarisë gjegjësisht veprimtarive organizohet nga anëtarët e Odës që i takojnë një veprimtarie konkrete gjegjësisht veprimtarive konkrete.

38.2. Secili anëtar i Odës lidhet drejtpërdrejtë në një shoqatë, varësisht nga veprimtaria e regjistruar që dominon në punën e tij, gjegjësisht sipas interesit që realizohet në shoqatën adekuate.

38.3. Secili anëtarë i Odës , po që se ka interes , përveç Shoqatës amë mundë të lidhet dhe të merr pjesë edhe në punën e ndonjë Shoqate tjetër por pa të drejtën e votës dhe përfaqësimit në organet qeverisëse të OEK-ut mbi këtë bazë.

Neni 39

39.1. Anëtarët e Odës marrin pjesë në punën e shoqatës përmes përfaqësuesve të vet të përhershëm ose të përkohshëm.

39.2. Shoqata punon në mbledhje plenare, në të cilat mund të marrin pjesë përfaqësues të të gjithë anëtarëve të shoqatës.

39.3. Shoqata sipas veprimtarisë punon drejtpërdrejtë në realizimin e qëllimeve dhe detyrave të anëtarëve të Odës, në veçanti:

- Shqyrton çështje që kanë të bëjnë me avancimin e punës dhe zgjidhjen e problemeve aktuale në veprimtari;
- Inicion dhe përcakton masa, plane dhe programe për zhvillimin e veprimtarisë,
- I harmonizon kundërthëniet dhe interesat e ndryshme të paraqitura në kuadër të veprimtarisë;
- Miraton konkluzat dhe propozon masa në interes të veprimtarisë, duke i pasur parasysh interesat e ekonomisë në tërësi;
- I analizon dhe përcakton interesat e përbashkëta të anëtarëve të Odës nga veprimtaria, si dhe kundërthëniet e paraqitura, në raport me veprimtaritë tjera dhe jep propozime për harmonizimin e tyre, gjegjësisht tejkalimin;

- Paraqet iniciativë për nxjerrjen e ligjeve dhe akteve të tjera dhe i shqyrton ato, jep mendime dhe propozime lidhur me çështje që janë në interes të anëtarëve të odës të veprimtarisë adekuate dhe të ekonomisë në tërësi;
- Inicion dhe realizon bashkëpunim lidhur me çështje nga interesi i përbashkët me anëtarë të odës nga shoqata të tjera në kuadër të Odës dhe bashkëpunim ndërkombëtar ekonomik, në harmoni me aktivitetet programore dhe aktet e përgjithshme të odës;
- Kryen punë të tjera në interes të anëtarëve, në kudër të kompetencave të Odës.

39.4. Organizimi dhe mënyra e punës së shoqatave rregullohet me Statut të shoqatave, në harmoni me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 40

40.1. Shoqatat bashkëpunojnë midis vetes në çështjet me interes të përbashkët.

40.2. Me qëllim të veprimit të koordinuar në çështjet nga interesi i përbashkët, këshillat drejtues të dy ose më shumë shoqatave mund të mbajnë seanca të përbashkëta.

40.3. Në qoftë se për ndonjë çështje me interes të përbashkët të shoqatave nuk arrihet pajtim midis dy ose më shumë shoqatave, ajo çështje, me qëllim të marrjes së qëndrimit përfundimtar, i drejtohet Këshillit Drejtues të Odës, me qëndrime të arsyetuara të shoqatave adekuate.

Neni 41

41.1. Shoqatat përbëhen nga të gjithë anëtarët e Odës të sektorit të caktuar.

41.2. Shoqatat sektoriale e zgjedhin Kuvendin e Shoqatës.

41.3. Kuvendi i Shoqatës sektoriale mundet të ketë numrin e anëtarëve nga 7 deri 50 anëtarë.

41.4. Nëse shoqata sektoriale numëron më pak se 50 anëtarë atëherë të gjithë anëtarët e Shoqatës së sektorit njëkohësisht janë dhe anëtarë të Kuvendit të Shoqatës.

41.5. Kuvendi i Shoqatës sektoriale zgjedhë Këshillin Drejtues, Kryetarin dhe nënkryetarët e Shoqatës.

41.6 Këshilli Drejtues i Shoqatës mundet ti ketë deri 25 përfaqësues.

41.7 Nëse Kuvendi i Shoqatës sektoriale ka më pak se 25 anëtarë atëherë të gjithë anëtarët e Kuvendit të Shoqatës janë njëkohësisht anëtarë të Këshillit Drejtues.

Neni 42

Njësitë Rajonale

42.1. Njësia Rajonale është formë territoriale e organizimit dhe punës në kuadër të Odës, përmes funksionimit të së cilës sigurohet decentralizimi i detyrave dhe aktiviteteve të Odës dhe vendimmarrje e pavarur e anëtarëve të Odës për çështje dhe detyra me rëndësi të veçantë për rajonin për territorin e të cilit është organizuar njësia.

42.2. Njësia Rajonale mund të organizohet për dy ose më shumë komuna.

Neni 43

43.1. Njësia Rajonale, në veçanti:

- Shqyrton çështje lidhur me përparimin e prodhimtarisë, qarkullimit dhe shërbimeve ekonomike dhe probleme aktuale të ekonomisë në rajonin për të cilin është organizuar;
- Realizon decentralizimin e detyrave dhe aktiviteteve të Odës në kuadër të rajonit;
- Shqyrton propozime dhe iniciacion nxjerrjen e akteve nga kompetenca e organeve të Odës;
- Shqyrton çështje dhe iniciacion propozime për zhvillimin e ndërmarresisë në rajon;
- Merr pjesë në përcaktimin e prioriteteve zhvillimore e strukturore të rajonit, veçmas në konceptimin e qëndrimeve dhe propozimeve për afarizëm ekologjik,
- zhvillimin e infrastrukturës ekonomike (rrugë Rajonale, energjetikë, transport e tjera);
- Iniciacion procedura për nxjerrjen e dispozitave dhe masave në lëmin e ekonomisë, në interes të ekonomisë në rajonin për të cilin është organizuar ose për ekonominë e vendit;
- Kryen shërbime afariste – profesionale dhe infrastrukturore në interes të ekonomisë së rajonit;
- Iniciacion dhe realizon bashkëpunim për çështje me interes të përbashkët me anëtarët e Odës nga rajonet fqinje ose me oda Rajonale të vendeve të tjera, në harmoni me aktivitetet programore ose aktet e përgjithshme të Odës;
- I harmonizon kundërthëniet e paraqitura dhe interesat e ndryshme midis anëtarëve të Odës në rajon;
- Kryen punë të tjera në interes të anëtarëve, në kuadër të kompetencave të Odës.

43.2. Organizimi dhe mënyra e punës së Njësive Rajonale rregullohet me rregulla, në harmoni me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 44

44.1. Njësia Rajonale ka Këshillin Drejtues si organ qeverisës dhe Kryetarin e saj.

44.2. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen në mbledhjen e Kuvendit të Njesisë Rajonale, nga radhët e përfaqësuesve të anëtarëve të Odës nga rajoni i Njesisë Rajonale.

44.3. Këshillat Drejtuese të Njësive Rajonale mund të kenë deri 11 anëtar.

Neni 45

Format tjera të organizimit dhe të punës

45.1. Krahas me format themelore të përcaktuara të organizimit dhe të punës së Odës, anëtarët me qëllim të shprehjes së interesave të veçanta mund të bashkohen në forma të ndryshme siç janë grupe të specializuara të degëve ose shoqatave, grupe të lobimit etj. Për këto destinime anëtarët mund të grumbullojnë mjete plotësuese në bazë vullnetare, po që se këto aktivitete për shkak të vëllimit dhe formës së tyre nuk mund të financohen nga mjetet e rregullta financiare të parapara për punën e Shoqatave të degëve përkatësisht të Njësive Rajonale.

45.2. Anëtarët të cilët themelojnë asociacione speciale në pajtim me paragrafin e mëparshëm, në mënyrë të pavarur vendosin mbi organet dhe mënyrën e punës së këtyre formave të organizimit.

45.3. Në Odë, kur ajo i shkon për shtati interesave të përbashkëta, mund të anëtarësohen edhe organizata që kryejnë aktivitete shoqërore, shoqata profesionale dhe

teknike dhe organizata të tjera të themeluara jashtë OEK-ut, të cilat me aktivitetin e tyre avancojnë punën dhe afarizmin e anëtarëve të Odës.

KREU VI BASHKËPUNIMI I ODËS ME SUBJEKTE TË TJERA

Neni 46

Në kuadër të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut, Oda bashkëpunon me organet kompetente shtetërore, organet e pushtetit vendor dhe me institucione të tjera veçanërisht gjatë përcaktimit të sistemit ekonomik, politikës zhvillimore dhe ekonomike, ngritjes së iniciativave për nxjerrjen e ligjeve dhe të dispozitave të tjera në lëmin e ekonomisë, përgatitjes së dispozitave ligjore dhe dispozitave të tjera nga lëmi i ekonomisë dhe çështje të tjera në interes të ekonomisë.

Neni 47

47.1. Oda bashkëpunon me Oda Ekonomike dhe me asociacione adekuate ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare dhe institucionet të tjera jashtë vendit, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit ekonomik dhe zhvillimit të bashkëpunimit ekonomik me jashtë.

47.2. Bashkëpunimi me odat dhe me asociacionet dhe institucionet tjera jashtë vendit realizohet përmes kontakteve të drejtpërdrejta, këmbimit të informatave, odave mike, këshillave të biznesit, organizimit të përbashkët të propagandës gjithë ekonomike dhe turistiko-informative, panairove dhe ekspozitave dhe aktiviteteve të tjera promovuese, vizitave me karakter pune, vendosjes së përfaqësimit të jashtëm tregtar, lidhmërisë dhe informimit afarist e të tjera.

KREU VII AKTET E PËRGJITHSHME TË ODËS

Neni 48

Aktet e përgjithshme të Odës janë: Statuti, rregulloret, vendimet, konkluzat, rekomandimet, qëndrimet, mendimet dhe aktet e tjera të përgjithshme që i nxjerrin Kuvendi, Këshilli Drejtues dhe organet e format e tjera të organizimit e të punës në kuadër të Odës, në pajtim me Ligjin e Odës dhe me këtë Statut.

KREU VIII GJYKATA E NDERIT DHE ARBITRAZHI I PËRHERSHËM

Neni 49

49.1. Oda ka Gjykatën e Nderit. Gjykata e Nderit kujdeset për zhvillimin, realizimin dhe ruajtjen e zakoneve të mira afariste.

49.2. Gjykata e Nderit vendos:

a). Për shkeljet e Statutit, dokumenteve të tjera dhe vendimeve të organeve të Odës në pajtim me Statutin e Odës.

49.3. Gjykata e Nderit shqipton dënime përcakton përgjegjësinë dhe nxjerr vendime për to në pajtim me statutin.

Neni 50

50.1. Në kuadër të Odës funksion Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit, si organ i pavarur.

50.2. Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit qeveriset me aktet dhe rregullat e miratuara nga Kuvendi i Odës.

50.3. Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit mund të vendosë për kontestet reciproke afariste midis anëtarëve të Odës, midis anëtarëve të Odës dhe personave të tretë si dhe midis personave të tjerë juridik në vend dhe nga jashtë, nëse palët bien dakord për kompetencën e kësaj gjykate.

KREU IX PUNA PUBLIKE E ODËS

Neni 51

51.1. Oda bën punë publike.

51.2. Oda publikon veprimtarinë e vetë në medime zyrtare dhe publike.

51.3. Oda e promovon veprimtarinë e vetë në opinion edhe përmes aktiviteteve të ndryshme publike (TV, radio, konferencave me gazetar, kumtesave për mjete të informimit etj.)

51.4. Oda e ka zëdhënësin e vet i cili promovon veprimtarinë e Odës në publik. Zëdhënësi i Odës emërohet nga Kryetari i Odës, përmes konkursit.

KREU X

Sekretari i Përgjithshëm i Odës

Neni 52

Sekretari i Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm i Odës, zgjidhet nga Kuvendi i OEK-ut, me propozimin e kryetarit të OEK-ut, me një mandat 4 vjeçar, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër. Pas skadimit të mandatit i njëjti sistemohet në njërin nga pozitat më të larta udhëheqëse të shërbimit profesional, në pajtim me strukturën organizative, në kohë të pacaktuar.

Sekretari i Përgjithshëm ushtron këto funksione;

52.1. Udhëheqë organizimin dhe punën e shërbimit profesional të Odës;

52.2. Merr vendime lidhur me marrëdhënien e punës të të punësuarve në shërbimin profesional të Odës;

52.3. Organizon përgatitjen dhe mbajtjen e seancave të Kuvendit e të Këshillit Drejtues;

52.4. Me autorizimin e Kryetarit, përfaqëson Odën në çështjet pronësore dhe çështjet tjera juridike – materiale;

52.5. Kryen punë të tjera në pajtim me Statutin dhe akte tjera të Odës.

KREU XI Shërbimi profesional i Odës

Neni 53

53.1. Oda e ka Shërbimin profesional për kryerjen e punëve që lidhen me aktivitetet e tërë mekanizmit të Odës në nivelin qendror, në nivelin e shoqatave të degëve dhe të Njësive Rajonale.

53.2. Shërbimi profesional i ka këto departamente:

- Departamenti për Politika dhe Komunikim Strategjik
- Departamenti për shërbime të përgjithshme për anëtarë dhe shoqata
- Departamenti për administratë, financa dhe teknologji informative
- Departamenti për Arsim profesional
- Menaxheri për cilësi

Neni 54

Departamenti për Politika dhe Komunikim Strategjik ka këto njësi:

- Zyra për Marrëdhënie me Publikun
- Zyra për Shërbime të Promovimit
- Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Zyra për Projekte
- Qendra për Analiza Ekonomike
- Akademia për Ndërmarrësi
- Zyra për legjislacion ekonomik, këshilla ligjore, çështje tatimore, tregtare dhe të investimeve

Neni 55

Departamenti për shërbime të përgjithshme për anëtarë dhe shoqata ka këto njësi:

- Zyra për Informata të Përgjithshme dhe marrëdhënie me anëtarë
- Zyra për Shoqatat e Sektorit të tregtisë me shumicë dhe pakicë, ndërtimit dhe shërbimeve
- Zyra për Shoqatat e Sektorit të bujqësisë, prodhimit, energjisë dhe ndërmarrjet eksportuese
- Zyrtarët për Rajonin – Qendra

Neni 56

Departamenti për administratë, financa dhe teknologji informative ka këto njësi:

- Zyra për Administratë
- Zyra për Financa
- Zyra për Teknologji Informative

Neni 57

Departamenti për Arsim profesional ka këto njësi :

- Zyra për Arsim profesional
- Zyra për Arsimim te vazhdueshëm

KREU XII

Financimi i Odës

Neni 58

58.1. Burimet e mjeteve për punën e Odës dhe për punën e shoqatave të degëve dhe Njësive Rajonale janë:

- kontributi i anëtarëve;
- pagesat e shërbimeve të kryera;
- mjetet posaçërisht të planifikuara për detyra të veçanta;
- mjetet nga buxheti i Kosovës për ushtrimin e autorizimeve publike;
- donacionet dhe burimet tjera

58.2. Bazë për përlogaritjen e kontributit të anëtarëve të Odës është përqindja e caktuar me vendimin e Kuvendit të Odës që lidhet me fondin e bruto të ardhurave personale të të punësuarve të kompanisë anëtare të Odës, përqindje kjo që në formë të kontributit paguhet për çdo muaj, në mënyrën siç vërtetohet me kontrata të veçanta të anëtarësimit në Odë.

58.3. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme Kuvendi i OEK përcakton lartësinë e anëtarësisë në formë paushallë.

Neni 59

59.1. Kontributi i tërësishëm i anëtarëve shpërndahet në këto pjesë:

- për punën të Odës;
- për punën e shoqatave të degëve;
- për punën e Njësive Rajonale;
- për punën e shërbimeve profesionale.

59.2. Shpërndarja e kontributit të anëtarëve bëhet në mbështetje të këtyre kriterëve: vëllimit të kontributit të grumbulluar në vitin e kaluar fiskal dhe vëllimit të të hyrave tjera të Odës, në kuadër të ndonjëres shoqatë të degës dhe të njësisë Rajonale; programeve të koordinuara të punës e të aktiviteteve dhe të planeve financiare të Odës dhe të atyre të shoqatave të degëve e të Njësive Rajonale; koordinimit të konsumit të mjeteve financiare të distribuara gjatë vitit, duke marrë parasysh edhe derdhjen e kontributeve të anëtarëve brenda shoqatës së degës individualisht ose Njësisë Rajonale.

Neni 60

Me qëllim të kryerjes së detyrave të caktuara plotësuese për të cilat janë të interesuar më shumë anëtarë, mund të grumbullohen mjete plotësuese në bazë vullnetare në nivelin qendror, në nivelin e shoqatave të degëve dhe në nivel të Njësive Rajonale. Me këto mjete plotësuese të grumbulluara disponojnë në mënyrë të pavarur ata që i kanë grumbulluar.

Neni 61

Shërbimet të cilat kanë domethënie më të madhe se sa ofrimi i konsultave të përgjithshme dhe që kërkojnë angazhim të ekspertëve të Odës individualisht sipas parimeve të organizatave të këshilldhënjes, mund të përlogariten dhe të paguhen ndaras.

Neni 62

Oda posaçërisht i përlogarit dhe paguan shërbimet që janë të lidhura me ushtrimin e autorizimeve publike, përpos në qoftë se financohen nga buxheti i Kosovës.

Neni 63

Anëtarët kolektiv i paguajnë kontributin vjetor për Odën në mbështetje të kontratës së veçantë mbi programin e punës dhe shërbimet që i kryen Oda për këta anëtar kolektiv si dhe për çështjet tjera që lidhen me bashkëpunimin reciprok.

Neni 64

Mjetet financiare për punën e Odës shpërndahen në pajtim me planet financiare të Odës në nivelin qendror, në nivelin e shoqatave të degëve dhe në nivelin e Njërive Rajonale, sipas pozicioneve përkatëse të konsumit.

Neni 65

Patundshmëritë dhe objektet me vlerë të përhershme si pjesë e pronës të Odës nuk mund të tjetërsohen, të vihen nën hipotekë ose të jepen pa kompensim, me përjashtim të rasteve kur është fjala për zgjidhje me të cilat rritet vlera dhe funksionaliteti i tyre, për çka vendos Kuvendi i Odës.

KREU XIII

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 66

66. Dispozitat e plotësuara dhe të ndryshuara të këtij Statuti të do të hynë në fuqi menjëherë ndërsa zbatimi i tyre fillon nga data e shpalljeve së zgjedhjeve të përgjithshme të radhës të OEK-ut.

Kuvendi i Odës Ekonomike të Kosovës

Prishtinë, 18.07.2017

Kryesuesi i Kuvendit

Xhevat Jusufi

